

**Njoftim i përqendrimit me të cilin KER TOKI PAUER SHA, Bullgari, do të fitojë kontrollin mbi
RENJUVABAL ENERXHI SUPLAJ RES SHPK Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut**

(lënda nr. 08-2/2024)

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ Nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 04.01.2024, te Komisioni i Mbrojtjes së Konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim, me të cilin KER TOKI PAUER SHA, me seli dhe adresë në qytetin e Sofjes, bul. „CAR OSvoboditel“ nr. 14, **Bullgari**, do të fitojë kontrollin e **RENJUVABAL ENERXHI SUPLAJ RES SHPK Shkup**, me seli në Bul. Shën Klimenti nr. 30, **Republika e Maqedonisë së Veriut**.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

KER TOKI PAUER AD ofron një gamë të gjerë shërbimesh me cilësi të lartë në fushën e blerjes, shitjes dhe shpërndarjes së pajisjeve që përdoret gjatë ndërtimit dhe funksionimit të termocentraleve fotovoltaike, si dhe aplikacioneve dhe objekte të tjera të bazuara në energjinë elektrike të prodhuar nga energjia diellore, blerjen, ndërtimin, funksionimin dhe menaxhimin e centraleve fotovoltaike/solare/energjetike, zgjidhjet e efikasitetit të energjisë, integrimin e sistemit dhe zhvillimin e softuerit, zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve të internetit dhe teknologjive të informacionit, mbështetjen e sistemeve kompjuterike, konsulencën, veprimtarinë ndërmjetësuese si dhe çdo aktivitet tjetër tregtar që nuk është i ndaluar nga ligjet e Republikës së Bullgarisë dhe që nuk kërkon leje paraprake (licencë), dhe në rast se kërkohet një leje për ndonjë nga aktivitetet e mësipërme, ajo do të zbatohet me marrjen e saj.

KER TOKI PAUER SHA nuk ka ndërmarrje-bijë, degë apo zyra përfaqësuese të vendosura në Maqedoninë e Veriut, as nuk ka gjeneruar të ardhura në vitin 2022 në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Veprimtaria e Shoqërisë për tregti dhe furnizim me energji elektrike RENJUVABAL ENERXHI SUPLAJ SHPK Shkup paraqet tregti me energji elektrike.

Sipas parashtruesit të njoftimit, për qëllime të vlerësimit të përqendrimit në fjalë, tregu relevant i produktit mund të përkufizohet si tregu i furnizimit dhe tregtisë së energjisë elektrike.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të mbërrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

11.01.2024

Shkup